

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku, kryetar, Afrim Shala dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit G.I., nga Ferizaj, për shkak të veprës penale të kanosjes, nga neni 185 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokatit V.M., e datës 5 mars 2018, të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1983/2017, i datës 17 janar 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 7 qershor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokat V.M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.1983/17, i datës 17 janar 2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin G.I., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të kanosjes, nga neni 185 paragrafi 2 të KPRK dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqind Euro), të cilin dënim, i pandehuri është i detyruar ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri nuk e paguan me kohë dënimin me gjobë, atëherë dënimi do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € (njëzet Euro) do ta mbajë 1 (një) ditë burgim.

Është detyruar i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

E dëmtuara L.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i palës së dëmtuar, avokati V.M., për shkak të vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet një dënim më i ashpër, duke e shndërruar në dënim me burgim efektiv apo edhe me kusht në periudhë sa më të gjatë verifikimi.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën PPA/II.nr.472/2018, të datës 8 maj 2018, ka propozuar që ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokat V.M. të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënim me burgim efektiv ose me kusht me afat të verifikimit më të gjatë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatojë se :

- ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatojë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij e as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit.

Sa i përket vendimit për dënimin, në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokatit V.M., theksohet se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe se ky dënim nuk është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit. Kjo për faktin se i pandehuri në vazhdimësi e ka kanosur në forma të ndryshme të dëmtuarën dhe se vetëm me dënim me burgim efektiv do të mund të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit. Gjithashtu, përfaqësuesi i palës së dëmtuar i referohet edhe disa rrethanave rënduese që është dashur t'i marrë në konsideratë gjykata e shkallës së parë, rrethana këto që parashihen në nenin 73 paragrafi 3 të KPRK. Në këtë aspekt, përfaqësuesi i palës së dëmtuar i referohet shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, pjesëmarrjes së personit të dënuar në kryerjen e veprës penale, moshës së të pandehurit dhe rrethanave tjera familjare. Duke ju referuar të gjitha këtyre rrethanave, përfaqësuesi i palës së dëmtuar në ankesë pretendon se me një dënim me burgim efektiv ose dënim me kusht në një periudhë sa më të gjatë verifikimi mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të paraqitura në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe shumës së dënimit, siç parashihet në nenet 73 dhe 74 të KPRK. Në këtë drejtim, si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata e shkallës së parë kishte marrë për bazë pranimin e fajësisë në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin e singertë dhe real për kryerjen e veprës penale, se i pandehuri më parë nuk kishte qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe moshën e tij të re, ndërsa nuk kishte gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, përveç vlerësimit të shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërisë konkrete të veprës penale. Duke i patur parasysh të gjitha këto rrethana të cilat i ka patur në konsideratë gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se dënimi i shqiptuar me gjobë ndaj të pandehurit G.I. është në harmoni me peshën e veprës penale, me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Andaj, duke i patur parasysh të gjitha këto që u cekën më lartë, propozimi i përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokatit V.M. që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënim me burgim ose dënim me kusht është i pa qëndrueshëm dhe i pabazuar, ngase edhe me dënimin me gjobë mund të arrihet qëllimi i dënimit i cekur më lartë.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.465/2018, Më 7 qershor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit
Afrim Shala

Kryetari i kolegjit,
Hashim Çollaku

Biljana Rexhiq